

SISTEMI GRAFIK-FONETIK I ZANOREVE DHE I BASHKËTINGËLLOREVE NË VEPRËN E NAUM VEQILHARXHIT

Gjustina Shushka

Beograd

KUD 809.198.3-4
Punim studimor

Marrë për botim, më 22 nëntor 1994

Përmbajtja e shkurtër: Në këtë studim bëhet analiza e të gjitha grafemave, format e tyre (të mëdha, të vogla, të dorës, të shtypit) dhe vlera tingullore të të dy Ëvetarët. Studimi paraqet përpjekjen e parë të bërë deri tashti të analizës së sistemit grafik të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve të këtij autori, duke i dhënë të plota, përveç zanoreve, edhe vlerat fonetike dhe fonologjike të bashkëtingëlloreve.

Pas analizës së bërë, shihet se alfabeti i Naum Veqilharxhit përbëhet nga 36 shkronja, nga të cilat dalin 7 zanore e që, sipas mendimit tonë, sistemi i zanoreve është si ai i shqipes letrare.

Në alfabet janë përfshirë dy grafema të ndryshme për tingullin **-h** / *h* / *h* / *h* për të cilat Naumi ka dhënë edhe vlera të ndryshme fonetike për ndonjë nauncë, si dhe dy shkronja -që kanë të njëjtën vlerë fonetike-për tingullin **-b** / *ε* / *ε* / *ε* (tek grupi i shkronjave të mëdha).

Alfabeti i Naum Veqilharxhit karakterizohet nga përdorimi i grafemave të thjeshta dhe të njëvlershme. Në Ëvetarin e parë (1844) autori jep shpjegimet e nevojshme për vlerën fonetike të shkronjave të alfabetit të ri duke dhënë për secilën shkronjë vlerën e njëjtë ose të afërt fonetike me shkronjat e alfabetit grek, frëng, gjerman e ndonjëherë edhe italian. Ndër këto shpegime autori jep edhe sqarime për ndërtimin e digrameve-**gj** / *g* / *g* dhe **-zh** / *z* / *z*, të cilat nuk janë paraqitur në tabelat e alfabetit të tij.

Vlera fonetike e shkronjave të alfabetit të Naum Veqilharxhit, sipas shpjegimeve të vetë autorit, paraqitet si vijon:

- α** -ja shqiptohet si **α=a**.
- ε** -ja s'është as **ε** as **i** si: *ε* / *ε* (është), *ε* / *ε* (sështë)...
- ε** -ja shqiptohet si **ε=e**.
- ι** -ja i përgjigjet **i-së**.
- ο** -ja i përgjigjet **o-së**.
- υ** -ja shqiptohet si **ou=u**.

- υ -ja s'është as ou , as t , por si frëngjisht **u**.
 y -ja shqiptohet si $\beta = \text{v}$.
 e -ja si $\mu\pi\acute{\epsilon}$ ose italisht - b.
 z -ja si $\gamma\gamma\acute{\alpha}$, si $\text{h}\acute{\epsilon}\text{z}\acute{\alpha}\text{i}$ (ngai). (Po këtu jep përmes shembujsh shkronjën që shënon tingullin **gj**, që paraqitet si kombinim i shkronjës **-g(γ)** me shkronjën **i**, pra
 $\text{z}\acute{\iota}$ -ja shqiptohet si **gji** si $\gamma\gamma\acute{\alpha}$, si $\text{h}\acute{\epsilon}\text{z}\acute{\alpha}\text{i}$ (ngjan, $\text{z}\acute{\iota}\text{n}$ (gje).
 h -ja shqiptohet si $\gamma\epsilon = \text{j}$ si $\text{h}\acute{\alpha}$ (ja)...
 u -ja si $\delta = \text{dh}$
 t -ja si $\nu\acute{\epsilon}$ ose italisht $\text{d} = \text{d}$
 l -ja si $\theta = \text{th}$
 ω -ja si $\text{z} = \text{z}$
 a -ja si $\text{n} = \text{k}$, $\text{a}\text{z}\acute{\alpha}$ (kam).
 ei -ja si $\text{κ}\acute{\iota}\acute{\alpha} = \text{q}$, $\text{ei}\acute{\alpha}\text{h}$ (qan).
 v -ja si $\lambda = \text{ll}$ $\text{v}\acute{\alpha}\text{z}\acute{\alpha}\text{i}$ (llamni).
 v -ja si $\lambda\acute{\alpha} = \text{l}$ $\text{v}\acute{\alpha}\text{h}$ (lan).
 s -ja si $\mu = \text{m}$
 h -ja si $\nu = \text{n}$
 h -ja si $\nu\acute{\alpha}$ ose italisht $\text{gna} = \text{nj}$, $\text{h}\acute{\epsilon}$ (një), $\text{h}\acute{\alpha}\text{b}\acute{\iota}$ (njeri).
 z -ja si $\pi = \text{p}$
 b -ja si $\rho = \text{r}$
 v -ja si $\sigma = \text{s}$
 v -ja si $\sigma\sigma\acute{\epsilon}$ si $\text{v}\acute{\alpha}\text{r}\acute{\epsilon}\text{z}\acute{\iota}$ (shtëpi)
 t -ja shqiptohet si $\tau = \text{t}$
 v -ja shqiptohet si $\varphi = \text{f}$
 h -ja s'është as α as χ , por si gjermanisht **h**: $\text{h}\acute{\alpha}$ (ha)
 $\text{h}\acute{\epsilon}\text{h}\text{z}\acute{\alpha}$ (hëngra).
 eh -ja si $\chi = \text{hi}$
 z -ja si $\tau\text{z}\acute{\epsilon} = \text{c}$
 ω -ja si $\tau\text{z}\acute{\iota}\acute{\epsilon} = \text{ç}$ ose **xh**
 s -ja si italisht **z**, ose si hsn (nxë) = **x**
 $\text{v}\omega$ -ja është sikur frëngjisht **j** ose $\text{z}\acute{\iota}\acute{\epsilon} = \text{zh}$

SISTEMI I ZANOREVE

Sistemi grafik

Grafema Q

Grafema Q në dy Ëvetarët e Naum Veqilharxhit na del në variantin e shkronjës së vogël dhe të madhe të dorës dhe në variantin e shkronjës së vogël dhe të madhe të shtypit. Vlera e shkronjave të mëdha është vetëm ortografike. Grafema Q është njëvlershe. Ajo shënon një zanore të ngritjes së ulët (të hapur) gojore [a]. Përdoret në pozicion të theksuar dhe të patheksuar; në rrokje të theksuar del e pashoqëruar me ndonjë shenjë të posaçme që shënon theksin.

Ajo del në pozicione të ndryshme, në rrokje të hapur dhe të mbyllur: **Ëvetar** (1), **tani**(1), **parherë** (1), **Naum** (1), **Panajot** (1), **Haxhi** (1) **Llazar** (1), **Veqilharxhi** (1), **nga** (1), **i parë** (11) etj.

Grafema **ɛ**

Grafema **ɛ** është njëvlershe. Ajo shënon një zanore, të ngritjes së mesme (gjysmë të mbyllur), qendrore, jobuzore gojore [ɛ]. Del në variantin e shkronjës së vogël e të madhe të dorës dhe të shtypit dhe përdoret në pozicion të theksuar e të patheksuar. Në rrokje të theksuar del e pashoqëruar me ndonjë shenjë të posaçme që shënon theksin. Ndeshet në pozicoione të ndryshme në rrokje të hapur dhe të mbyllur.

[ɛ] e theksuar në **Ëvetarin** e parë gjendet: **dhënë** (1), është' erëndë, **gjëset** (2) **mëndjës**, **sbën**, (4) **ubëftë** (6), **bëjinë**, **bësh**, **është**, **rëndje**, **gjë**, të **rënda**, **këmba**, **kuvëndim**, **vëndi** (7), **mos zësh**, **mënt**, **tënt**, të **tëmë**, **gjë prej**, **gjëje** (8).

[ɛ] e patheksuar në **Ëvetarin** e parë del në: **i shkurtër**, **i përdorshim**, **si cillë**, **qëdo**, të **mpsonjë**, të **kënduarit**, **dhenë**, **parherë**, **mbë dritë**, **gjendësit**, **bëntorit**, **i këtyre**, të **shkruumëve**, **këti**, **i thonë**, **Kolonjës**, **i parë** (11).

Në disa raste në vend të shkronjës që shënon tingullin fundor **ë** të patheksuar, **Naum** **Veqilharxhi** përdor apostrofin: **Epar'** e tëmpsuarit **frik'** e perëndisë, çdo enisur **q'** është' e rëndë, **ska njeri** që nuk' edi (2) është' **elehët**, **far'** eti (7). Pra ë-ja fundore e patheksuar bie kur fjala që vjen pas fillon me zanore.

Grafema **ɶ**

Edhe grafema **ɶ** është njëvlershe. Shënon një zanore të ngritjes së mesme (gjysmë të mbyllur), të përparme, jobuzore, gojore [ɶ]. Del në variantin e shkronjës së vogël e të madhe të dorës dhe të shtypit dhe përdoret në pozicione të ndryshme, në rrokje të theksuar e të patheksuar, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës, në rrokje të hapur dhe të mbyllur:

[ɶ] e theksuar në **Ëvetarin** e parë (1844) del: **llëvezhgënë**, **ecënjë**, **gjësant** (4) **je**, **emëri**, **erhtë**, **dhe**, **nemnae**, **ndëje**, **ndëjejmë**, **lerë**, të **keqe** (6), **sta ze**, të **gjesh** (7).

[ɶ] e patheksuar në **Ëvetarin** e parë (1844): **Epar'** e tëmpsuarit, **frik'** e perëndisë, **vihet**, **slihet**, **gjëset** (2) , **vjyerë**, (f.4), **qiell**, **u shenjtëroftë**, **jote**, **e ngadiçme**, **fajetë**, të **heqe** (6).

Grafema ĩ

Grafema **ĩ** është njëvlershe. Shënon një zanore të ngritjes së lartë (të mbyllur) të përparme, jobuzore [ĩ]. Del në variantet e shkronjës së vogël e të madhe të dorës dhe të shtypit. Ndeshet në pozicion të theksuar e të patheksuar, në rrokje të hapur e të mbyllur, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës:

[ĩ] e theksuar në Ëvetarin (1884) e Naum Veqilharxhit del: shqip, si cillë, tani, dritë (1), këti, Haxhi (1), frik' e perëndisë, enisur, njeri, di, vihet, mbinjë, slihet, ati (2), qiell, e liga, Amin (6)...

[ĩ] e patheksuar në Ëvetarin e parë haset: i shkurtë e i përdorshim, të kënduarit, të shkruarit, gjendësit, bëntorit, Ëvetarit, Bredhi, Veqilharxh, Bythkuqi (1), të mpsuarit (2), emëri, e ngadiçme, sindërku, (6) i punçmi, (7)...

[ĩ] në dy Ëvetarët e Naum Veqilharxhit del edhe si **ĩ**. Autori shënon se "shenja gjysmëzëese detyron shkurtimin e shprehjes si **vaji** (qarje, ulërim) dhe jo **vaji** (i ullirit)" (41). Këtu po japim disa shembuj nga Ëvetari i parë (1844) dhe i dytë (1845):

Ëvetari i parë: prej^ĩ (1), faj^ĩtorëtë, ndëj^ĩjimë hyj^ĩmë (6), bëj^ĩinë, kuj^ĩ, keq^ĩ (7), të huaj^ĩ, e huaj^ĩ, prej^ĩ (8);

Ëvetari i dytë: prej^ĩ (1), juaj^ĩ (2), prej^ĩ (3), huaj^ĩ (6), dergj^ĩji, huaj^ĩ (7), e huaj^ĩ (9), tuaj^ĩ (11), gjithësej^ĩ (34). Por në fq. 12 gjejmë edhe formën **të huaj**.

Kjo shenjë **ĩ** siç u pa më sipër bashkohet edhe me shenjen që shënon tingullin **g** për të dhënë tingullin [gj] **gĩ**.

Grafema O

Edhe grafema [o] është njëvlershe. Shënon një zanore të ngritjes së mesme (gjysmë të mbyllur), të prapme buzore [o]. Del si të gjitha zanoret në variantet e shkronjës së vogël dhe të madhe të dorës dhe të shtypit. Ndeshet në pozicion të theksuar e të patheksuar në rrokje të hapur e të mbyllur, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Ja disa shembuj:

[o] e theksuar në Ëvetarin e parë (1844) ndeshet: Fort, i përdorshim, çdo të mpsojë, bëntorit, Panajot, Kolonjës, Mot (1), çdo, po, kushdo, do, shpëton (2), mos shëko, vështro, gojën ato, Dora (4), u shenjtëroftë, jote, sot, tona, fajtorëtë, shpëto (6). zgjodha, Ajo sbesohet, çdo, dora, duron, trashëgon, i zoti, të mpsosh, ato (7), zoti, mos, poshtë, tu punosh, zotit, kot, shenjtosh, puno, mbaro, çlodhu, ajo, Ndero, të rosh (8);

[o] e patheksuar në Ëvetarin (1844) e parë ndeshet: Kolonjës (1), porosi (7), Porositë, ndonjë (8)...

Grafema **V**

Grafema **V** është njëvlershe. Shënon një zanore të ngritjes së lartë (të mbyllur), të prapme, buzore [u]. Del në variantet e shkronjës së vogël e të madhe të dorës dhe të shtypit. Ndeshet në pozicion të theksuar e të patheksuar, në rrokje të hapur e të mbyllur, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Po japim disa shembuj me zanore **V**.

[**U**] e theksuar në Ëvetarin e parë ndeshet: i shkurtër, të kënduarit, të shkruarit, bukur, Naum, Bythkuqi (1); tëmpsuarit, kur (2), gjuhën, e shtërnguarë (4), bukën (6), të shkruar, kush, shumë, i punçmi, ipapunçmi, smunt, kuji, gjuha, turp, i turpëruar. (7), mb'ujë, e Shëtunë, punërat, e tua, shumë, grua, të huaji (8).

[**U**] e patheksuar në Ëvetarin e parë ndeshet: bukur (1), enisur, nuk'e di, kushdo (2), dheut, duron, njeriut, kuvëndin, e vdekur, i turpëruar (7), të gdhendur, tu punosh, puno, çlodhu, Mos kurvërosh, punëtorë (8)... "u-ja del e dyfishuar në Ëvetarin e parë (1844) si: të shkruumëve (1).

Grafema **Ÿ**

Grafema **Ÿ** është e përbërë nga shenja që shënon shkronjën [u] dhe nga shenja diakritike **˘** që vendoset sipër saj. Është grafemë njëvlershe. Shënon një zanore të ngritjes së lartë (të mbyllur), të përparme buzore [**Û**]. Del me variantet e shkronjës së vogël dhe të madhe të dorës dhe të shtypit. Ndeshet në pozicion të theksuar e të patheksuar në rrokje të hapur dhe në rrokje të mbyllur, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës.

Po japim disa shembuj me zanoren y nga Ëvetari i parë dhe i dytë:

[**y**] e theksuar: këtyre (1), të vjyerë (4), jynë, jyt, të hyjimë (6), ay, ty, pa çpërblyer (7), jyt, ty, rëfyer, sy (8)...

[**y**] e patheksuar: Bythkuqi (1), Myzeqesë (1), qytet (3), të qyteçm (3), yshqimnë (40), të yshqehesh (32).

Në dy Ëvetarët e N. Veqilharxhit në një numër të kufizuar rastesh kemi ndeshur edhe dyfishimin e zanoreve:

aa: Avraami (36, 37)

Hanaan (41)

Isaaknë (37)

Isaakut (37)

ee: leet (=lind, do të lindë) (36)

ëë: gjëëtar (gjuetar) (38)

ii: odhiiqitis (43)

yy: ndedyyshme=dyshim (6)

uu: të shkruumëve=shkronjave (1).

Këto janë të vetmet raste me dyfishim të zanoreve në të dyja tekstet e Ëvetarëve të Naum Veqilharxhit. Dyfishimi i **a**-së ndeshet vetëm te disa emra të përveçëm biblikë. Numri i rasteve të zanoreve të dyfishuara është aq i paktë, sa kurrsesi nuk të shtyn të mendosh për praninë e zanoreve të gjata me vlerë funksionale në gjuhën e teksteve në shqyrtim. Gjithsesi nuk përjashtohet mundësia që autori me këtë rast të ketë dëgjuar variante fonetike me gjatësi fizike (të matshme) më të madhe e ta ketë shënuar me dyfishimin e zanoreve, një traditë kjo mjaft e përhapur në shkrimet e autorëve të vjetër si: Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi e Bogdani.¹

Sistemi i zanoreve

Sistemi i zanoreve pas analizës së materialit gjuhësor të paraqitur në dy Ëvetarët e Naum Veqilharxhit paraqitet, sipas mendimit tonë, si i shqipes letrare.

Pra kemi shtatë fonema zanore, që dallohen sipas shkallës së hapjes, sipas vendit të formimit dhe sipas pjesëmarrjes së buzëve (buzorësisë).

Sipas shkallës së hapjes dallohen tri grupe zanoresh: të mbyllura /i, y (ü), u/, gjysmë të mbyllura /e, ë, o/ dhe të hapura /a/. Sipas vendit të formimit dallohen tri grupe zanoresh: të përparme /i, y, e/, qendrore /ë (ə), a/ dhe të prapme /u, o/. Në të vërtetë /a/ nuk është as e përparme as e prapme.

Sipas pjesëmarrjes së buzëve dallohen dy grupe zanoresh: buzore /y, u, o/ dhe jobuzore /i, e, ë, a/.

Pra sistemi i zanoreve në Ëvetarët e Naum Veqilharxhit karakterizohet nga tri lloj kundërvëniesh: 1) sipas shkallës së hapjes: /i/~ /e/ /ë/~ /a/ /u/~ /o/; 2) sipas vendit të formimit: /y/~ /u/, /e/~ /ë/ dhe 3) sipas pjesëmarrjes së buzëve: /i/~ /y/.

SISTEMI I BASHKËTINGËLLOREVE

Sistemi bashkëtingëllor

Sistemi grafik (shkronjat)

Naum Veqilharxhi, duke folur për alfabetin e tij, në f. 14 të Ëvetarit (1845), ndër të tjera ka shkruar se "Ëvet shqipe ndahen mbë dy: mbë zëtoze (fonienda gërqiisht) edhe mezëtoze (simfona). zëtozet janë shtatë: **Q, E, N, I, O, V, V̇**; mezëtoret janë njëzet e gjashtë.

¹ Shih për këtë: Prof. Shaban Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Rilindja, Prishtinë, 1989, f. 251-252.

у	ε	з	ж	л	т	л	∞	а
v	b	g	j	dh	d	th	z	k
v	b	g	j	ð	d	θ	z	k
ei	у	у	з	л	т	з	л	у
q	ll	l	m	n	nj	p	r	s
φ	ł	l	m	n	n	p	r	s
ш	ł	л	л	л	л	л	л	л
sh	t	f	h ¹	h ²	c	ç (xh)	x.	
š	t	f	h ¹	h ²	ts	tš	dz.	

Këtu duhen shtuar edhe dy grafema që shënojnë tingujt **gj** dhe **zh**: $\text{ʒi}^s = \text{gj}$ [ʒ], $\text{ʒ} = \text{zh}$ [ʒ].

Pra, gjithsej alfabeti i Naum Veqilharxhit ka 28 shkronja, që shënojnë 27 bashkëtingëllore të shqipes së sotme letrare, konkretisht bashkëtingëlloret: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, s, sh, t, th, v, x, z, zh, si edhe një variant të fonemës /h/: $\text{ç} = \text{h}^2$.

Këtij alfabeti i mungon një shkronjë e veçantë për tingullin **rr**, gjë që shpjegohet, besojmë ne, me mungesën e këtij tingulli në sistemin fonetik të së folmes të rrethinave të Korçës prej nga kishte origjinën autori i Ëvetarëve.²

Në alfabetin e Naum Veqilharxhit mungon një shkronjë e posaçme edhe për tingullin **xh** [dʒ]. Nga analiza që i kemi bërë tekstit të tërë të të dy Ëvetarëve del se në këto tekste ka vetëm disa fjalë që përmbajnë tingullin **xh**, është ofiqi, Haxhi dhe mbiemri i autorit Veqilharxhi, emri i krahinës së Lunxhërisë, por haset edhe në emrin me origjinë turke borxhin. Në të gjithë shembujt e përmendur autori e shënon tingullin **xh** me shkronjën w : $\text{h} \text{w} \text{w} \text{i}$ (11).

$\text{y} \text{n} \text{e} \text{i} \text{v} \text{ç} \text{e} \text{b} \text{w}$ (11), $\text{v} \text{r} \text{ç} \text{e} \text{b} \text{i} \text{v} \text{e}$ (32),
 $\text{e} \text{o} \text{b} \text{w} \text{i} \text{ç}$ (92). Kjo tregon se kemi të bëjmë me një shkronjë polifunksionale. Për të ilustruar mendimin tonë po japim disa shembuj nga Ëvetarët e Naum Veqilharxhit:

$\text{w} \text{t} \text{o}$	çdo (11, 2)
$\text{ç} \text{t} \text{e} \text{i} \text{z} \text{r} \text{ç} \text{w} \text{ç} \text{i}$	Ndë i punçmi (71)
$\text{w} \text{e} \text{v} \text{ç} \text{e} \text{w}$	çë sta ze (71)
$\text{y} \text{n} \text{w} \text{ç} \text{n} \text{ç} \text{n}$	veç meje (81)
$\text{ç} \text{ç} \text{e} \text{w} \text{ç} \text{ç} \text{e}$	nga çjanë (81)
$\text{w} \text{ç} \text{o} \text{v} \text{ç}$	çlodhu (81)
$\text{w} \text{ç} \text{ç} \text{e} \text{b} \text{i}$	Çamëri (32)
$\text{t} \text{n} \text{w} \text{ç} \text{i} \text{n} \text{ç}$	deç gjet (42)

² Jorgji Gjinari, "Dialektologjia shqiptare", Tiranë, 1966, f.45/36.

նձ օօհեկ	eç shohën (52)
ճենձ	mbeç (52)
Ջեբ քե օրտւիք	për të çuditur (62)
Յօձ Վիփիճ	poç fitim (72)
Սոձ հիլիկ	seç hiqin (72)
քե քոձոն	të veçme (11)
քե Վեհնձոն	të fjeçme (11)
քե քոձօ	të veçm (14)
ձոն-ե-ճե	çje -rë - më (20)
քե օրտւիձոն	të çudiçme (21)
նձօձօձօ	epaçmuar (21)
Ձկնար	Çnuku (22)
ձոնո	çedo (26)
քե օրեօհիօհի	të çfajtohet (32)
ձօճեկ	çoban (33)
նձօձոնկձոն	epamençme (35)
Ջոձօ	plloçat (46)
քոնե ճեկձ	vunë menç (48)
Յօ օրձօ հօքոն	as çupa jote (50)
ճո Տիլե ձեձե	me gjithë çkanë (50).

Në këto rrethana nuk qëndron mendimi i I. Hoxhës që "Naum Bredhi ka përdorur shumë dendur [**xh**] -në, jo vetëm për të paraqitur tingullin përkatës, por edhe [**ç**] - në, e aq më pak argumenti i tij se, kjo gjë duket se ka ndodhur për shkak se bashkëkrahinasit e Naum Bredhit edhe ata të krahinave rreth e qark së parës, edhe sot në vend të [**ç**]-së shqiptojnë më shpesh [**xh**]- në, kështu p.sh. ata thonë **xhë** thua, **xh**lodhu, **vexh** (për veç), **xh**do (për çdo) etj.³ **Të paktën nga botimet e derisotme dialektologjike një gjë e tillë nuk vërtetohet. Pritej që me këtë rast autori të bënte citime të nevojshme. Gjithsesi, në kundërshtim me I. Hoxhën ne mendojmë se fjalët e transkriptuara prej tij me **xh**, si **xh**do, **xhë** sta zë këmba, të **mënxhme**, **vexh**, nga **xh**janë, **nqadalxhme**, **xhpërblyer**⁴ duhen transkriptuar me [**ç**], pra: **çdo**, **çjanë** etj.**

Në alfabetin e Naum Veqilharxhit interes të veçantë paraqesin shkronjat **h** dhe **ç**. Për të parën autori ka shkruar se nuk është as [**α**] as [**χ**] por si gjermanishte [**h**], kurse për të dytën se është si [**ç**] greke. Duke vështuar me kujdes të dyja tekstet e N. Veqilharxhit, del se **h** përdoret në pozicione të ndryshme në fjalë si këto:

³ I.Hoxha, *Nëpër udhën e pendës shqiptare*, Tiranë, 1986, f.92.

⁴ I.Hoxha, *Vep. e cit. f. 92.*

a) h + zanore: b) zanore + h + za- c) zanore + h në
nure fund të fjalës:

H axhi (1)	bëhi (2)	snjeh (41)
të h equr (3)	vihet (21)	njeh (71)
H imarë (3)	slihet (21)	e njeh (8)
h apësh (41)	gjuhën (41)	u ftoh (20)
herje (5)	kohë (5)	i njeh (21)
(të) h ymë (61)	të njohë (5)	sheh (28)
(një) h erë (71)	të njohur (6)	shih (33)
(të) h uaj (81)	mundohem (6)	u njih (33)
u hap (20)	punohen (6)	u njoh (47)
H am (34)	sheher (6)	
	shohëm (6)	
	sbesohet (71)	
	elehët (71)	
	njihet (71)	

Shembuj me shkronjën

*çk*²

b. z+ h + z

epihiris (9)
shohëmë (10)
Lëshohi (12)
koha (20)
eftihia (21)
dhistihi (21)
ahere (31) etj.
tihu (40)
aharisti (46)

Fjala parherë bën përjashtim sepse këtu kemi bashkimin e dy fjalëve par (ë) herë, pra: h + zanore.

Po kështu edhe *çk*² përdoret në pozicione të ndryshme. Përveç pozicioneve të mësipërme kemi edhe:

a) bashkëtingëllore + h

Veqil**h**arxhi (3)
er**h**omenon (6)
shimatizo (9)

b) h + bashkëtingëllore

mënxehnë (8)
e nj**h**nja (9)
(të) mprehtë (11)
nj**h**ni (16)
nj**h**nin (7)
u mfshehnë (31)
baht (40)
nd**h**mën (47)
tërkohnjë (47)
etj.

Në materialet e sjella këtu bie në sy që shkronjën \mathfrak{h} të cilën e shpjegon me [h] gjermane, nuk e përdor asnjëherë në fjalët me origjinë greke. Në këto fjalë përdor sistematikisht \mathfrak{c} , të cilën e krahason me [x] greke: *erhomenon*, *epihirisis*, *shimatizo*, *eftihia*, *dhistihi*, *aharisti* etj. Por edhe në përdorimin e këtyre shkronjave autori ka lëkundje. Nga materialet tona shihet se edhe shkronjën \mathfrak{c} e ka përdorur mjaft shpesh në fjalët shqipe, gjë që tregon se N. Veqilharxhi krahas h-së faringale të shqipes ndjente edhe një [h] të palatalizuar të tipit [hi] të greqishtes që shënonte një variant fonetik të [h]-së.

Në alfabetin e Naum Veqilharxhit tërheq vëmendjen edhe përdorimi i dy shkronjave paralele për të shënuar tingullin **b**. Kjo duket vetëm në tabelën e shkronjave të mëdha të dorës në Ëvetarin e parë (1844) ku shënon për shkronjën [b] shenjat: \mathfrak{E} dhe \mathfrak{h} . Po kështu ndodh edhe në tabelën e shkronjave të mëdha të dorës në Ëvetarin e dytë (1845), por kësaj radhe i vendos me rend të kundërt: \mathfrak{h} dhe \mathfrak{E} .

Në tekstet e të dy Ëvetarëve për të shënuar tingullin [b] zakonisht përdor shkronjën \mathfrak{E} , e shkronjën \mathfrak{h} e përdor vetëm në Ëvetarin e parë (1844) tek këto fjalë: *bukur* (11), *bëntorit* (11), *Bredhi* (11), *bukën* (61), u *bëftë* (61), *mbë* (61), *mos ja bësh* (71), *bëj* (71). Me sa duket kemi të bëjmë me një lëkundje që lidhet me fazën e parë të punës së tij, prej së cilës më vonë autori heq dorë, pra nuk është fjala për variante fonetike të [b]-së ose diçka tjetër, po thjesht për një lëkundje që me arritjen e përvojës së autorit vjen e mënjanohet plotësisht në Ëvetarin e dytë (1845).

Pra, përfundimisht alfabeti i Naum Veqilharxhit ka këto bashkëtingëllore:


\mathfrak{E}	\mathfrak{z}	\mathfrak{w}	\mathfrak{t}	\mathfrak{u}	\mathfrak{r}	\mathfrak{s}	\mathfrak{si}				
b,	c,	ç (xh),	d,	dh,	f,	g,	gj,				
\mathfrak{h}	\mathfrak{c}	\mathfrak{z}	\mathfrak{a}	\mathfrak{v}	\mathfrak{r}	\mathfrak{s}	\mathfrak{h}	\mathfrak{p}	\mathfrak{z}	\mathfrak{e}	\mathfrak{b}
h ¹ ,	h ² ,	j,	k,	l,	ll,	m,	n,	nj,	p,	q,	r,
\mathfrak{v}	\mathfrak{v}	\mathfrak{f}	\mathfrak{l}	\mathfrak{y}	\mathfrak{z}	\mathfrak{w}	\mathfrak{w}				
s,	sh,	t,	th,	v,	x,	z,	zh,				


Siç duket, për të shënuar bashkëtingëlloret në të dy Ëvetarët e N. Veqilharxhit janë përdorur gjithsej 28 shkronja nga të cilat 27 monofunkionale dhe vetëm një polifunkionale, që shënon paralelisht tingujt [ç dhe xh].


Nga 28 shkronjat e përdorura për bashkëtingëlloret 24 janë të thjeshta, kurse 4 janë të përbëra si: \mathfrak{si} (=gj), \mathfrak{e} (=q), \mathfrak{v} (=sh), \mathfrak{w} (=zh). Nga këto dy janë digrame \mathfrak{si} (=gj) dhe \mathfrak{w} (=zh), kurse dy janë monograme të shoqëruara me shenja diakritike: \mathfrak{e} (=q) dhe \mathfrak{v} (=sh).

Të gjitha shkronjat bashkëtingëllore dalin edhe si të mëdha kur shënojnë fillimin e fjalisë ose fillimin e emrave të përveçëm. Vlera e shkronjave të mëdha është vetëm drejtshkrimore.


Grafema \mathfrak{E} shënon një bashkëtingëllore dybuzore të zëshme, mbylltore [b].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare të shurdhët mbylltore (afrikate) [ɬ].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore alveolare të shurdhët, mbylltore (afrikate) [tʃ].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore dhëmbore të zëshme, mbylltore [d].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore dhëmbore të zëshme, fërkimore [ð] (dh).


Grafema  shënon një bashkëtingëllore buzore-dhëmbore të shurdhët, fërkimore [f].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore grykore të zëshme, mbylltore [g].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore të zëshme, mbylltore [ʒ].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore grykore të shurdhët fërkimore [h].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore të shurdhët fërkimore [x].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore të zëshme fërkimore [j].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore grykore të shurdhët mbylltore [k].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare anësore [l].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveodhëmbore anësore [ɫ].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore dybuzore hundore [m].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore dhëmbore hundore [n].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore hundore [ɲ].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore dybuzore të shurdhët, mbylltore [p].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore të shurdhët, mbylltore [q].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare njëdridhëse [r].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare të shurdhët, fërkimore [s].


Grafema  shënon një bashkëtingëllore qiellzore - alveolare, të shurdhët, fërkimore [ʃ].

Grafema  shënon një bashkëtingëllore dhëmbore të shurdhët, mbylltore [t].

Grafema  shënon një bashkëtingëllore ndërthëmbore të shurdhët, shtegore apikale [θ].

Grafema  shënon një bashkëtingëllore buzore dhëmbore të zëshme, fërkimore [v].

Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare të zëshme, mbylltore (afrikate) [dz].

Grafema  shënon një bashkëtingëllore alveolare të zëshme, fërkimore [z].

Grafema *U* shënon një bashkëtingëllore qiellzore- alveolare të zëshme, fërkimore [ʒ].

Sistemi i bashkëtingëlloreve

Sistemi i bashkëtingëlloreve mbi bazën e analizës së materialit gjuhësor të paraqitur në të dy Ëvetarët e Naum Veqilharxhit paraqitet në një sistem kryesor dhe në fonemat anësore. Sistemin kryesor e përbëjnë njësitë që krijojnë kundërvënie ose bashkëlidhje dhe radhë bashkëlidhjesh në bazë të tipareve dalluese.

Bashkëlidhja kryesore është bashkëlidhja e zëshmërisë që përbëhet nga dhjetë çifte:

$\frac{p}{b}$	$\frac{t}{d}$	$\frac{k}{g}$	$\frac{f}{v}$	$\frac{th}{dh}$	$\frac{q}{gj}$	$\frac{c}{x}$	$\frac{\zeta}{xh}$	$\frac{s}{z}$	$\frac{sh}{zh}$
---------------	---------------	---------------	---------------	-----------------	----------------	---------------	--------------------	---------------	-----------------

Bashkëtingëlloret b, d, g, v, dh, gj, mbartin tiparin ose treguesin e zëshmërisë, janë pra të shënuara (markuara).

Bashkëlidhja tjetër është bashkëlidhja mbylltore fërkimore:

$\frac{p}{f}$	$\frac{b}{v}$	$\frac{t}{th}$	$\frac{d}{dh}$	$\frac{c}{s}$	$\frac{x}{z}$	$\frac{\zeta}{sh}$	$\frac{xh}{zh}$	$\frac{gj}{j}$	$\frac{k}{h}$
---------------	---------------	----------------	----------------	---------------	---------------	--------------------	-----------------	----------------	---------------

Të shënuara janë bashkëtingëlloret fërkimore.

Bashkëtingëlloret m, n, nj dallojnë nga të tjerat në radhë të parë për shkak të hundorësisë së tyre. Me këtë tipar ato u kundërvihen bashkëtingëlloreve gjegjëse gojore. Kështu formohet bashkëlidhja e hundorësisë:

$\frac{b}{m}$	$\frac{d}{n}$	$\frac{gj}{nj}$
---------------	---------------	-----------------

Në të vërtetë dy seritë korrelative të bashkëtingëlloreve mbylltore (p c q) dhe (b x gj) kundërvihen me serinë e bashkëtingëlloreve hundore (m n nj) dhe formojnë një tufë bashkëlidhjesh të formuar nga tri seri bashkëtingëlloresh:

p	t	q
b	d	gj
m	n	nj

Sipas vendit të formimit dallojmë: buzore, dhëmbore, alveolare, qiellzore-alveolare, qiellzore dhe grykore.

buzore: p, b, f, v, m
 dhëmbore: t, d, th, dh, n
 alveolare: c, x, s, z
 qiellzore-alveolare: ç, xh, sh, zh
 qiellzore: q, gj, j, nj
 grykore: k, g, h.

Johundoret janë të lidhura me korrelacione të zëshme (të shurdhëta dhe mbylltore) fërkimore. Disa prej tyre e kanë gjymtyrën korresponduese.

Sistemi anësor (lateral) përbëhet nga fonemat **r, l, ll**, që nuk hyjnë në këto korrelacione. Bashkëtingëllorja **r** është dirdhëse (njëdridhëse), kurse bashkëtingëlloret **l, ll** dallohen nga të tjerat si anësore, ndërsa ndërmjet tyre si alveolare dhëmbore ose majore velare.

Gjystina Shushka

THE GRAPHIC - PHONETIC SYSTEM OF VOWELS AND CONSONANTS IN THE WORK OF NAUM VEQILHARXHI

(S u m m a r y)

Our evaluation of the alphabet of Naum Veqilharxhi is based on the work of this author. In our evaluations, we have our critic attitude towards the contribution of some authors in ascertaining the phonetic value of alphabet of Veqilharxhi.

Out of 36 letters that were used by Naum Veqilharxhi, 35 were single ones, and the letter marking the sound [tS] was polyvalent and was used also to mark the sound [dʒ]. This alphabet lacked a special letter to denote the sound [rr].

It is important to point out that Naum Veqilharxhi overcame polyvalence of the graphemes of the former authors proceeding the principle of the Balkan neighbours of 19th century, that shows his seriousness, a new phase of the Albanian script.

